



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 17/2014
PËR FORMËN, PAJISJEN DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MIA) NO. 17/2014
FOR THE FORM, EQUIPMENT AND WAY OF USING THE IDENTIFICATION DOCUMENT

ADMINISTRATIVNO UPUSTVO (MUP) BR. 17/2014
ZA FORMIRANJE, OPREMU I NAČIN KORIŠĆENJA IDENTIFIKACIONOG DOKUMENTA

<p>Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme,</p> <p>Në mbështetje të nenit 31, paragrafit 1.2 të Ligjit nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr. 87, të datës 16.11.2010), nenit 8, nënparagrafit 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 38, paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, datë 12.09.2011),</p> <p>Nxjerr:</p> <p>UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 17/2014 PËR FORMËN, PAJISJEN DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT</p> <p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim që të përcaktoj formën, përmbajtjen, procedurën e nxjerrjes, prodhimin dhe përdorimin e dokumenteve të identifikimit (kartelat dhe distinktivët) për punonjësit e IPK-së, të kontraktuesve dhe vizitorëve, që hyjnë në ndërtesat e Inspektoratit Policor të Kosovës.</p>	<p>Minister of the Ministry Internal Affairs,</p> <p>Pursuant to Article 31, paragraph 1.2 of the Law no. 03/231 for Police Inspectorate of Kosovo (Official Gazette no. 87, dated 16.11.2010) Article 8, subparagraph 1.4 of the Regulation no. 02/2011 administrative areas of responsibility for the Office of the Prime Minister and Ministers, as well as Article 38, paragraph 6 of the Rules of Procedure of the Government no. 09/2011 (Official Gazette no. 15, dated 12.09.2011),</p> <p>Issues:</p> <p>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MIA) NR. 17/ 2014 ON THE FORM, THE DEVICE AND METHOD OF USE OF THE IDENTIFICATION DOCUMENT</p> <p>Article 1 Purpose</p> <p>This Administrative Instruction is intended to determine the form, content, procedure of issuance, producing and use of identity documents (cards and badges) for employees of PIK, contractors and visitors, who enter in the premises of Police Inspectorate of Kosovo.</p>	<p>Ministar Ministarstva Unutrašnjih Poslova,</p> <p>U skladu sa članom 31. stav 1.2 Zakona br. 03/231 Policijski Inspektorat Kosova (Službeni glasnik, br. 87, dana 16.11.2010) člana 8, tačka 1.4 Pravilnika br. 02/2011 za odgovorne administrativne oblasti Kancelarije Premijera i Ministara, kao i člana 38, stav 6 Poslovnika Vlade br. 09/2011 (Službeni glasnik, br. 15, dana 12.09.2011),</p> <p>Izdaje:</p> <p>ADMINISTRATIVNO UPUSTVO (MUP) BR. 17/2014 ZA OBLIK, OPREMU I NAČIN KORIŠĆENJA IDENTIFIKACIONOG DOKUMENTA</p> <p>Član 1 Svrha</p> <p>Ovo Administrativno uputstvo ima za cilj da odredi oblik , sadržaj, postupak izdavanja , proizvodnju i korišćenje identifikacionih dokumenata (kartice i značke) za zaposlene u PIK-a, izvođače radova i posetilaca koji ulaze u prostorije Policijskog Inspektorata Kosova.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 2 Pajisja me kartelë identifikuese dhe mënyra e aplikimit</p> <p>1. Punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës do të pajisen me kartelë identifikimi, pas plotësimit të formularit/kërkesa për lëshimin e kartelës identifikuese.</p> <p>2. Pjesën e parë të formularit e plotëson aplikuesi, pjesa e dytë plotësohet vetëm nga mbikëqyrësi i aplikuesit (drejtori i departamentit ose ekuivalent) dhe duhet vulosur, ndërsa pjesa e tretë është për Divizionin e Burimeve Njerëzore.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Provision of identification card and method of application</p> <p>1. Employees of the Police Inspectorate of Kosovo shall be provided with an identification card, after completing the forms-application for issuance of identity card.</p> <p>2. The first part of the form completes the applicant, the second part completed just by the applicant's supervisor (department director or equivalent) and must be stamped, while the third part of the form is for the Division of Human Resources.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Opremanje sa identifikacionom karticom i naćin korišćenja</p> <p>1. SluŹbenici Policijskog Inspektorata Kosova se trebaju opremiti (zaduŹiti) identifikacionom karticom, nakon ispunjavanja obrasca (zahteva) za izdavanje identifikacione kartice.</p> <p>2. Prvi deo obrasca popunjava podnosioc zahteva, drugi deo se potpunjava samo od strane rukovodioca podnosioca zahteva (direktor sektora ili slićnog) i mora biti overen, dok je treći deo za Odeljenja za Ljudske Resurse.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përmbajtja e kartelës identifikuese</p> <p>1. Të gjitha kartelat identifikuese të punonjësve të Inspektoratit Policor të Kosovës duhet të jenë me Stemën e Republikës së Kosovës dhe stemën zyrtare të Inspektoratit Policor të Kosovës, me fotografi të personit dhe shënohet me shkronja të mëdha të shtypit: Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Inspektorati Policor i Kosovës, emri dhe mbiemri i punonjësit, pozita, numri i kartelës identifikuese, barkodi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Content identification card</p> <p>1. All identification cards of Police Inspectorate of Kosovo employees should be with the emblem of the Republic of Kosovo and the official emblem of the Police Inspectorate of Kosovo, with a photo of the person and marked with big press letters: Republic of Kosovo, Government of Kosovo, Ministry of Internal Affairs, Police Inspectorate of Kosovo, the employees name and surname, position, identification card number, barcode.</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Sadržaj identifikacione kartice</p> <p>1. Sve identifikacione kartice sluŹbenika Policijskog Inspektorata Kosova treba da poseduju grb Republike Kosova i zvanićni amblem Policijskog Inspektorata Kosova, sa fotografijom osobe i obeleŹene velikim štampanim slovima; Republika Kosova, Vlada Kosova, Ministarstvo Unutrašnjih Poslova, Policijski Inspektorat Kosova, ime i prezime zaposlenog, poloŹaj, broj id kartice i barkod.</p>

<p>2. Për punonjësit e IPK-së të autorizuar për bartjen e armeve, përpos të dhënave nga paragrafi 1 i këtij neni, kartela identifikuese e tyre do të përmbaj edhe këto të dhëna shtesë, grupin e gjakut, llojin dhe numrin e armës.</p> <p>3. Të gjitha kartelat identifikuese duhet të jenë të shkruara në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.</p> <p>4. Kartelat identifikuese duhet të jenë në pajtim me formën dhe dukjen, që i bashkëngjiten këtij Udhëzimi Administrativ (Shih: Shtojca 1-Fig.1).</p>	<p>2. For PIK Employs, authorized to carry weapons, except data's from paragraph 1 of this article, their identification card shall have those additional data's, blood group, type and number of weapons.</p> <p>3. All identification cards must be written in Albanian, Serbian and English language.</p> <p>4. Identification cards must be in accordance with the form and appearance, which are attached to this Administrative Instruction (See Appendix 1-Fig.1).</p>	<p>2. Za zaposlene u PIK-a, ovlasceni da nose oružije, osim podatka iz stava 1 ovog člana, njihova identificirana kartica imaće i ove podatka, krvna grupa, tip i broj oružja.</p> <p>3. Sve identifikacione kartice moraju biti ispisane na albanskom, srpskom i engleskom jeziku.</p> <p>4. Identifikacione kartice moraju biti u skladu sa oblikom i izgledom, koji su pridododani ovom Administrativnom Uputstvu (videti Dodatak 1 - slika 1).</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4 Ndërrimi i kartelës identifikuese</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 Replacement of ID card</p>	<p style="text-align: center;">Član 4 Promena identifikacione kartice</p>
<p>1. Në rast të ndërrimit të vendit të punës ose avancimit, apo dëmtimit të kartelës, punonjësi duhet të plotësojë kërkesën për lëshimin e kartelës së re identifikuese dhe në këtë rast duhet të shënohen të dhënat e reja.</p> <p>2. Kartela e mëparshme e identifikimit duhet t'i dorëzohet Divizionit të Burimeve Njerëzore.</p> <p>3. Në rast të kalimit të afatit të kartelës identifikuese, punonjësi duhet të plotësojë formularin e kërkesës për lëshimin e</p>	<p>1. In case of change of working place or promotion, or damage to the card, the employee must complete the application for issuance of new identification card and in this case should be marked new data's.</p> <p>2. Previous identification card must be submitted to the Human Resources Division.</p> <p>3. In case of the expiration of the identification card, the employee must complete the application form for issuing</p>	<p>1. U slučaju promene radnog mesta , napredovanja ili oštećenja kartice , zaposlenik mora popuni zahtev za izdavanje nove identifikacione kartice i u ovom slučaju trebalo bi se napišu nove informacije.</p> <p>2. Prethodna identifikaciona kartica mora biti dostavljena Divizijonu za Ljudske Resurse.</p> <p>3. U slučaju isteka identifikacione kartice, zaposlenik treba da popuni obrazac zahteva za izdavanje nove identifikacione kartice.</p>

<p>kartelës së re identifikuese. Kartela e mëparshme e identifikimit duhet t'i dorëzohet Divizionit të Burimeve Njerëzore.</p> <p>4. Divizioni i Burimeve Njerëzore i bën të pavlefshme kartelat e identifikimit të dorëzuara dhe sipas kërkesave të punonjësve ato mund t'ua kthejnë atyre prapë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Lëshimi i kartelës identifikuese në rast të humbjes</p> <p>Në rast të humbjes së kartelës identifikuese, punonjësi duhet të plotësojë formularin e kërkesës për lëshimin e kartelës së re identifikuese, e cila përcillet edhe me një shkresë, të nënshkruar nga punonjësi dhe mbikëqyrësi i tij, lidhur me vendin dhe ditën e humbjes të kartelës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Kartelë identifikimi për kontraktuesit</p> <p>1. Kartelë identifikimi do të kenë edhe kontraktuesit, që kanë kontratë më tepër se një muaj me Inspektoratin Policor të Kosovës.</p> <p>2. Kartelat për kontraktuesit duhet të përfshijnë këto të dhëna: Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të</p>	<p>new identification card. Previous identification card must be submitted to the Division of Human Resources.</p> <p>4. Division of Human Resources makes invalid identification cards submitted and according to employees request they may return them back.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Issuing identification card in case of loss</p> <p>In case of loss of identity card, the employee must complete the application form for issuing new identification card, which is followed by a letter, signed by the employee and his supervisor, concerning the place and date of card loss.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Identification card for contractors</p> <p>1. Identification card will also have contractors that have a contract for more than a month with the Police Inspectorate of Kosovo.</p> <p>2. Cards for contractors should include the following information: Republic of Kosovo, Ministry of Interior, Police Inspectorate of</p>	<p>Prethodna identifikaciona kartica mora biti dostavljena Divizionu za Ljudske Resurse.</p> <p>4. Divizion Ljudskih Resursa čini nevažećom dostavljene identifikacione kartice, i prema zahtevu zaposlenika one mogu biti vraćene se istima.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Izdavanje identifikacione kartice u slučaju gubitka</p> <p>U slučaju gubitka identifikacione kartice, službenik popunjava obrazac zahteva za izdavanje nove identifikacione kartice, koje će biti popraćena i sa jednim pismom, potpisano od strane zaposlenika i njegovog pretpostavljenog u vezi sa mestom i datum gubitka kartice.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Identifikaciona kartica za izvođače radova</p> <p>1. Identifikacionu kartica će takođe posedovati izvođači radova koji imaju ugovor na period duži od mesec dana sa Policijskim Inspektoratom Kosova.</p> <p>2. Kartice za izvođače radova treba da sadrži sledeć e informacije : Republika Kosovo, Ministarstvo Unutrašnjih Poslova,</p>
---	--	---

<p>Brendshme, Inspektorati Policor i Kosovës, fotografia e personit, emri dhe mbiemri, data e kalimit të afatit, emri i institucionit dhe i ndërtesës në të cilën lejohet hyrja (Shih shtojca 1- Fig-2).</p> <p>3. Pas përfundimit të kontratës, kontraktuesit janë të obliguar t'i kthejnë kartelat identifikuese në Divizionin e Burimeve Njerëzore në IPK.</p> <p>4. Kontraktuesit afatshkurtër, më pak se një muaj, marrin kartelat e vizitorëve për kohën e qëndrimit në ndërtesë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Kartela e vizitorëve</p> <p>1. Me kartelë vizitore do të pajisen vizitorët e Inspektoratit Policor të Kosovës (Shih shtojca 1-Fig. 3).</p> <p>2. Kartela vizitore duhet të jenë me Stemën e Republikës së Kosovës dhe Stemën e Inspektoratit Policor të Kosovës e cila do të përmbaj këto të dhëna: Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Inspektorati Policor i Kosovës, emrin e ndërtesës, numrin e kartelës dhe vitin (Shtojca 1-Fig.3) dhe vlejnjë vetëm për lëvizje brenda ndërtesës së cekur në kartelë.</p>	<p>Kosovo, the person's picture, name and surname, date of expiry, name and institution building in which is allowed to entry (Annex 1 Fig-2).</p> <p>3. Upon completion of the contract, contractors are obliged to return the identification cards in the Division of Human Resources in PIK.</p> <p>4. Short-term Contractor, less than a month, takes the visitors cards for the time spent in the building.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Visitors' card</p> <p>1. Visitors card will receive visitors of Police Inspectorate of Kosovo (Annex 1-Fig.3).</p> <p>2. Visitor cards must have emblem of the Republic of Kosovo and Emblem of Kosovo Police Inspectorate and shall contain the following information: Republic of Kosovo, Ministry of Interior, the Police Inspectorate of Kosovo, the name of the building, card number and year (Appendix 1-Fig.3) and applies only for a movement inside the building mentioned in the card.</p>	<p>Policijski Inspektorat Kosova, slika, ime i prezime lica, datum isteka, ime institucije i zgrade u kojoj je dozvoljen ulaz (Aneks 1 slika - 2).</p> <p>3. Po završetku ugovora , izvođači su dužni da vrate identifikacione kartice Divizionu za Ljudske Resurse u PIK-a.</p> <p>4. Izvođači radova sa sa kraćim vremenskim periodom, manjim od mesec dana dobijaju kartice posetilaca za vreme boravka u zgradi.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Kartice za posetioce</p> <p>1. Kartice za posetioce će dobiti posetioci Policijskog Inspektorata Kosova (Aneks 1 - Sl.3).</p> <p>2. Kartice za posetioce moraju i posedovati amblem Republike Kosovo i Policijskog Inspektorata Kosova i takođe da sadrži sledec e podatke: Republika Kosovo, Ministarstvo Unutrašnjih Poslova, Policijski Inspektorat Kosova, naziv zgrade, broj kartice i godina (Prilog 1 - Sl.3), i važi samo za kretanje unutar zgrade koja je navedena na kartici.</p>
--	---	---

<p>3. Vizitori do të pajiset me kartelë të vizitorit dhe do t'i lejohet hyrja në ndërtesë, vetëm pasi të ketë dorëzuar në recepcion një dokument identifikimi të vlefshëm me fotografi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Prodhimi dhe lëshimi i kartelave identifikuese</p> <p>Kompetent për prodhimin dhe lëshimin e kartelave identifikuese është Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme/ Divizioni i Burimeve Njerëzore, që vepron në kuadër të IPK-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Përdorimi i kartelës identifikuese</p> <p>1. Të gjithë punonjësit në Inspektoratin Policor të Kosovës, duhet të posedojnë kartelë identifikimi.</p> <p>2. Dhënia e kartelës së identifikimit personit tjetër është shkelje e rëndë e detyrave të punës, keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe ndëshkohet në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Bartja e kartelës identifikuese</p> <p>1. Të gjithë punonjësit e Inspektoratit</p>	<p>3. The visitor will be provided with a visitor card and will be allowed entry into the building, only after having delivered a valid identification document with a photo in reception.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Production and issuance of identity cards</p> <p>Competent for producing and issuing identification is the Department of Finance and General Services / Human Resources Division, which operates under the PIK.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Using identification card</p> <p>1. All employees in the Police Inspectorate of Kosovo shall possess an identification card.</p> <p>2. Providing identification card to another person is a serious breach of work duties misuse of official position and is punishable in accordance with the legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Carrying of identification card</p> <p>1. All Police Inspectorate of Kosovo</p>	<p>3. Posetilac će se zadužiti karticom za posetioce i dozvolice mu se ulazak u zgradu, samo nakon što se dostavi na recepciji važeća dokumenta sa fotografijom .</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Proizvodnja i izdavanje identifikacione kartice</p> <p>Nadležan za proizvodnju i izdavanje identifikacione kartice je Departman za Finansije i Opšte Usluge/ Divizion Ljudskih Resursa, koja posluje u okviru PIK-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Upotreba identifikacione kartice</p> <p>1. Svi službenici Policijskog Inspektorata Kosova trebaju imati identifikacionu karticu.</p> <p>2. Pozajmljivanje identifikacione kartice drugoj osobi je ozbiljno kršenje službenih obaveza zloupotrebu službenog položaja i kažnjava se važećim zakonima.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Nošenje identifikacione kartice</p> <p>1. Svi službenici Policijskog Inspektorata</p>
--	---	---

<p>Policor të Kosovës duhet ta bartin me vete kartelën identifikuese në vend të dukshëm gjatë orarit të punës, si dhe gjatë hyrjeve në ndërtesat e institucioneve të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Të gjithë vizitorët në Inspektoratin Policor të Kosovës duhet të kenë kartelë të vizitorit dhe atë ta bartin me vete në vend të dukshëm gjatë vizitës në ndërtesat e Inspektoratit Policor të Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Dorëzimi i kartelës identifikuese</p> <p>1. Me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës obligohen t'i dorëzojnë kartelat e identifikimit në Divizionin e Burimeve Njerëzore.</p> <p>2. Divizioni i Burimeve Njerëzore, pasi e merr kartelën nga zyrtari, atij ia lëshon vërtetimin për ndërprerjen e kontratës së punës.</p> <p>3. Mosdorëzimi i kartelave identifikuese është shkelje e rregullave të punës dhe bartja e paautorizuar e dokumenteve zyrtare do të sanksionohet në pajtim me legjisllacionin në fuqi.</p>	<p>employees shall carry identification card with them in a visible place during working hours, as well as when they entry in to the buildings of the institutions of Republic of Kosovo.</p> <p>2. All visitors in Police Inspectorate of Kosovo shall have the visitor card and carry it with them in a visible place while visiting the premises of Police Inspectorate of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Handover of ID card</p> <p>1. In the case of termination of employment, employees of Police Inspectorate of Kosovo are required to submit identity cards at Division of Human Resources.</p> <p>2. Division of Human Resources, after submission of the card from employee, he shall issue a certificate of termination of the employment contract.</p> <p>3. Failure to submit identity cards is a violation of labor rules and unauthorized possession of official documents will be sanctioned in accordance with the legislation in force.</p>	<p>Kosova treba da nose sa sobom Identifikacionu karticu na vidnom mestu tokom radnog vremena, kao tokom ulaska u zgradama institucija Republike Kosova.</p> <p>2. Svi posetioci Policijskog Inspektorata Kosova trebaju imati karticu za posetioce i treba ju je nositi sa sobom na vidnom mestu u tokom poseta prostorijama Policijskog Inspektorata Kosova.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Predaja identifikacione kartice</p> <p>1. U slučaju prestanka radnog odnosa, službenici Policijskog Inspektorata Kosova dužni su da vrate identifikacionu karticu Divizijonu za Ljudske Resurse.</p> <p>2. Divizijon za Ljudske Resurse, pošto dobija karticu od službenika, njemu i izdaje potvrdu o prekidu ugovora o radu.</p> <p>3. Ne vraćanje identifikacione kartice je kršenje radnih pravila rad i neovlašćeno nošenje zvaničnih dokumenta i bić e sankcionisano u skladu sa zakonima na snazi.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 12 Vlefshmëria e kartelës identifikuese</p> <p>Vetëm kartelat e identifikimit të lëshuara nga Inspektorati Policor i Kosovës, të cilat përmbajnë të dhënat e parapara në pajtim me këtë Udhëzim Administrativ, janë të vlefshme dhe mund të përdoren nga punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 The validity of the identification card</p> <p>Only identification cards issued by the Police Inspectorate of Kosovo, which contain the data provided pursuant to this Administrative Instruction are valid and can be used by employees of the Police Inspectorate of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Važenje identifikacione kartice</p> <p>Samo identifikacione kartice izdate od strane Policijskog Inspektorata Kosova, koje sadrže podatke predviđene na osnovu ovog Administrativnog Uputstva su na raspolaganju i mogu se koristiti od strane zaposlenika Policijskog Inspektorata Kosova.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Përtëritja e kartelës identifikuese</p> <p>Divizioni i Burimeve Njerëzore/IPK do të bëjë përtëritjen e kartelave identifikuese të punonjësve, në afat prej tre muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi Administrativ.</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Renewal of identity card</p> <p>Division of Human Resources / PIK will make renewal of employees' identification cards, within three months from the entry into force of this Administrative Instruction.</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Obnova identifikacione kartice</p> <p>Divizijon za Ljudske Resursa /PIK-a će obaviti obnovu kartice zaposlenicima, koji poseduju važeće kartice u roku od tri meseca od dana stupanja na snagu ovog Administrativnog Uputstva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Distinktivi</p> <p>1. Distinktivi është shenjë (simbol) që prezanton identitetin zyrtar të IPK-se dhe shërben si dëshmi / autorizim për të vepruar në emër të saj.</p> <p>2. Me distinktiv pajisen punonjësit operativ te IPK-së (Hetuesit dhe Inspektoret) dhe bartet së bashku me kartelën identifikuese (shtojca 1, fig 4).</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Badge</p> <p>1. Badge is a sign (symbol) that presents the official identity of the PIK and serves as proof / authorization to act on its behalf.</p> <p>2. With the Badge shall be equipped operative employees of PIK and they will carry it together with identification card (Appendix 1, Figure 4).</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Značka</p> <p>1. Značka je znak (simbol) koji ukazuje na zvanični identitet Agencije i služi kao dokaz/ovlašćenje dodeluje u njegovo ime.</p> <p>2. Značkom se oprema(zadužuje) operativno osoblje PIK-a i nosi se zajedno sa identifikacionim karticama (Prilog 1 , slika 4).</p>

3. Distinktivi përmban stemën e IPK-se të gravura në metal, të shtresuar në tri nivele. Në pjesën e poshtme të saj duhet të shtypet numri personal i punonjësit të IPK-së, i cili duhet të përputhet me numrin e kartelës së identifikimit.

**Neni 15
Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ nr. 06/2011-MPB për Dokumentet e Identifikimit të Punonjësve të IPK-së.

**Neni 16
Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri.

Bajram Rexhepi

Ministër i Ministrisë së Punëve të
Brendshme

05.12.2014

3. Badge contains PIK emblem engraved in the metal, stratified into three levels. At its bottom should be printed PIK employees' personal number, who must comply with the identification card number.

**Article 15
Repeal**

With the entry into force of this Procedure, Administrative Instruction No. repealed. 06/2011-MIA Employee Identification documents KPI.

**Article 16
Entry into force**

This Administrative Instruction enters into power seven (7) days after the signature by the Minister.

Bajram Rexhepi

Minister of the Ministry Internal
Affairs

03.12.2014

3. Značka sadrži amblem PIK-a urezana u metalu, podeljen na tri sloja. Pri dnu se treba doštampati lični broj radnika PIK-a, koji se mora podudarati sa ličnim brojem identifikacione kartice.

**Član 15
Ukidanje**

Stupanjem na snagu ove procedure, ukida se Administrativno uputstvo br. 06 /2011 – MUP za Identifikacionu Dokumentaciju Službenika PIK-a.

**Član 16
Stupanje na snagu**

Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana nakon potpisa, od strane Ministra.

Bajram Rexhepi

Ministar Ministarstvo Unutrašnjih
Poslova

03.12.2014

SHTOJCA . 1

FIGURA 1. KARTELA IDENTIFIKUESE/ IDENTIFICATION CARD/ IDENTIFIKACIONA KARTICA

PARA/ FRONT/ PREDNJA

PRAPA/ BACK/ POZADINA

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrasnih Pošlova – Ministry of Internal Affairs</p> <p>INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA – POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO</p>	
	<p>Mbiemri Prezime Surname</p> <p>Emri Ime Name</p> <p>Pozita Pozicija Position</p>	
<p>Nr. i karteles: Br. kartice: ID. number:</p>	<p>KARTEL IDENTIFIKUESE IDENTIFIKACION KARTICA IDENTITY CARD</p>	

<p>Poseduesi i kësaj kartele është i punësuar në Inspektoratin Policor të Kosovës dhe ka të gjitha të drejtat dhe autorizimet policore që dalin nga Ligji për IPK-në, Ligji për PK-në dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.</p> <p>Vlasnik ove kartice zaposlen je u Policijskom Inspektoratu Kosova i uživa sva policijska prava koja proizlaze iz zakona PIK-a, policijskog zakona i drugih važećih zakona u Republici Kosova.</p> <p>The bearer of this card is employed with the Police Inspectorate of Kosovo and is entitled to all rights and authorizations deriving from PIK law, Police law and other applicable laws in the Republic of Kosovo.</p>
<p>Gjinia/ Pol/ Gender</p> <p>Grupi i gjakut/ Krvna grupa/ Blood type</p> <p>Lloji/Nr. i armes/ Tip/Br. oruzja/ Type/ Weapon no.</p>
<p>NËNSHKRIMI / POTPIS / SIGNATURE</p>

FIGURA 2. KARTELA IDENTIFIKUESE E KONTRAKTORËVE TË IPK-SË/ CONTRACTOR IDENTIFICATION CARD OF PIK/ IDENTIFIKACIONA KARTICA IZVOĐAČA RADOVA PIK-A

PARA/ FRONT / PREDNJA

PRAPA/ BACK/ POZADINA

Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Ministria e Punëve të Brendshme
 Ministarstvo Unutrašnjih Poslova – Ministry of Internal Affairs
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
 POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA – POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

KONTRAKTOR /UGOVOREN/CONTRACTOR

Emri/Ime/Name: _____

Pozita/Pozicija/Position: _____

Nr. i kartelës/ Br. Kartice /Card no: _____

Objekti:
IPK, Hajvali “Objekti Qendror”

FOTO

Data e skadimit:
 Datum isteka:
 Expire date

FIGURA 3. KARTELA E VIZITORËVE/ VISITOR CARD / KARTICA ZA POSETIOCE

PARA /FRONT/ PREDNJA



PRAPA/ BACK/ POZADINA




FIGURA 4. DISTINKTIVI DHE KARTELA IDENTIFIKUESE/ BADGE AND IDENTIFICATION CARD/ ZNAČKA I IDENTIFIKACIONA KARTICA

